

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari Adem Shabani, me sek. Juridike Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.Xh.nga fshatiKomuna Kaçanik, për shkakë të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga nen. 297 par 5 lidhur me par 3 dhe par. 1. të KPPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj PP.nr.1737/2008 dt.23.04.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me date 08.08.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit të shtetit Visar Musa, të akuzuarin,dhe mbrojtësit të tij av.E.Sh. të njejten ditë muarrë dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari E.Xh., nga fshati, Komuna Kaçanik, data e lindjes....., nga i ati R. dhe e ëma H. e gjinis N., ka të kryer shkollen e mesme , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,mbi tetë vite nuk jeton në Republikën e Kosovës , dy vite ka jetuar në shtetin e Sllovenisë e tani në shtetin e Anglisë, i martuar babë i dy fëmive, i gjendjes së mesme, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse me dt.25.10.2008, rreth orës 15:30, në magjistralen Ferizaj-Prishtinë,derisa ishte duke drejtuar veturën e tipit “VW Golf 4”me ngjyrë të kaltërt,me targa të regjistrimit, duke vepruar me kundërshtim me nenin 54 të LTHSKRR-së,nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve,në atë mënyrë që mw të arritur në fshatin, përshkak të mospërshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes,kushteve dhe dukshmërisë së rrugës,në momentin që këmbëtori,tani i dëmtuari F.V. ndërmer veprimin e trupimit të rrugës,nga ana e majtë në të djathtë i pandehuri me të vrejtur këtë ndërmer veprimin e frenimit,mirëpo në pamundësi që ta ndalë veturën,përshkak të shpejtësisë së lëvizjes, e godet të dëmtuarin-këmbësorin, me pjesen e pare të djathtë të veturës dhe e hedhë jashtë rruge në drejtim të lëvizjes së tij,me ç’rast nga forca goditëse i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore dhe atë:thyerje e reg.subtrohanterik të femurit të djathtë,thyrje e nëngjurit të majtë, të cilat lëndime kanë shkaktuar paaftësim të poërkohshëm dhe zvogëlim të poërkohshëm të aftësisë së personit për të punuar.

- me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nen.297 par.5 lidhur me par.3 dhe par.1 të KPPK- së.

Andaj gjykata në bazë të nen. 3,34, 36, 38, 64 dhe 66 të KPK-së dhe neneve 361 dhe 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/ muajve.

Me pëlqimin e të dënuarit konform nenit 38 par.3 të KPK-së gjykata dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve e zëvendson me dënim me gjobë në shumë prej 1.350 (njëmijë e treqind e pesëdhjetë) €, të cilën gjobë i akuzuari është i obliguar ta paguajë nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin në të holla si zëvendësim i dënimit me burgim në afatin e përcaktur, i akuzuari do të vuajë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve.

Të dëmtuarin F.V., nga fshati, Komuna Fereizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike u udhëzuan në kontest civil.

I pandehuri obligohet që në emër shpenzimet e procedurës penale të paguaj 70€ si dhe paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €.

A r s y e t i m i

Prokuroria Publike Komunale në Ferizaj me propozim akuzën PP.nr.1737/2008 dt.23.04.2009, e ka ngarkuar të akuzuarin E.Xh., nga fshati, Komuna Kaçanik. për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nen. 297 par 5 lidhur me par3 dhe par 1. të KPPK-së .

Gjykata në këtë çështje penale kishte marrur disa here veprime procedurale por nga fletëkthesdat shpërndarësit e postës kishin theksuar se i pandehuri nuk jeton në Republikën e Kosovës pasi ai që një kotë tregjatë jeton në shtetin e Anglisë e gjykata për të siguruar prezencën e të pandehurit kishte lëshuar Letërrreshtim Qendror dhe me të kthyer në Republikën e Kosovës policia e kishte njoftuar se duhet të paraqiten në gjykatë ku i nejtë është paraqitur në gjykatë me dt.08.08.2016.

Gjykata e konform nenit 245 par.1 të KPPK-së,në të njejtën datë ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Visar Musa, i pandehuri E.Xh. ,mbrojtësi i tij av.E.Sh., dhe vllau i të dëmtuarit V.V..

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari e njofton të pandehurin dhe mbrojtësin e tij avokatin lidhur me aktakuzen që është ngitur kundër të pandehurit ku ai ka thekësuar se nuk e mohon veprën për të cilën akuzohet por mbi tetë vite nuk gjindet në Republikën e Kosovës .Në fillim ishte në shtetin e Sllovenisë kurëse tani në shtetin Anglez ku atje tani është maruar dhe puno.Deri me tani nuk ka pranuar nga gjykata ë aktakuzë por pajtohet që tani ti dorzohet në ekzemplarë i saj dhe pas leximit dhe konsultimit me mbrojtësin e tij janë pajtuar që të mbahet shqyrtimi fillestar.

Në fillim të shqyrtimit filletsra i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dëmtuarit e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari E.Xh. ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke thekësuar se është e vërtetë që aksidenti i përashkruar në aktakuzë , në momentin që këmbësori,tani i dëmtuari ndërmerr veprimin e trupimit të rrugës, nga ana e majtë në të djathtë me të vrejtur ka ndërmarr veprimin e frenimit,mirëpo në pamundësi që ta ndalë veturën ka goditur të dëmtuarin ku më pas është ndalë dhe i ka ofruar dimë,e ku edhe pasë aksidentit sa ishte në Kosovë është interesuar për gjendjen e tij shëndetësore ,e këtë nuk e ka bërë me dashje por ka ndodhur siq mundet me i ndodhur çdo vozitësi në komunikacion, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merrë për bazë pranimin e fajsisë dhe i ka kërkuar falje edhe vllaut të tijë që ishte prezent në shqyrtim gjyqësor.

Mbrojtësi i të pandehurit av.E.Sh. e pranon pranimin e fajsisë për veprën penale që akuzohet i mbrojturi i tij,me që veprën penale që i vëhet në barrë nuk e ka kryer me dashje,është penduar,ka bërë kërkim falje ku edhe vet të pandehurin e kanë goditur pasojat e kësaj veprë penale.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajsisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajsisë,mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurri i shtetit Visar Musa ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit.

Megjense i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPRK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par 4 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë ligjore dr. B.I., ortoped-traumatolog i dt.28.03.2009, në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit rrugor inxh i dip. M.A. i dt.22.01.2009, si dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës e nga të cilat është vërtetuar kjo gjendje faktike:

me dt.25.10.2008, rreth orës 15:30, në magjistralen Ferizaj-Prishtinë, derisa ishte duke drejtuar veturën e tipit "VW Golf 4" me ngjyrë të kaltërt, me targa të regjistrimit, duke vepruar me kundërshtim me nenin 54 të LTHSKRR-së, nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që mw të arritur në fshatin, përshkak të mospërshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes, kushteve dhe dukshmërisë së rrugës, në momentin që këmbësori, tani i dëdmtuari F.V. ndërmerr veprimin e trupimit të rrugës, nga ana e majtë në të djathtë i pandehuri me të vrejtur këtë ndërmerr veprimin e frenimit, mirëpo në pamundësi që ta ndalë veturën, përshkak të shpejtësisë së lëvizjes, e godet të dëmtuarin-këmbësorin, me pjesen e pare të djathtë të veturës dhe e hedhë jashtë rrugë në drejtim të lëvizjes së tij, me ç'rast nga forca goditëse i dëmtuari pëson lëndime të rënda trupore dhe atë: thyerje e reg.subtrohanterik të femurit të djathtë, thyerje e nëngjurit të majtë, të cilat lëndime kanë shkaktuar paaftësim të poërkohshëm dhe zvogëlim të poërkohshëm të aftësisë së personit për të punuar.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha tiparet e veprës penale penale rrezikim i trafikut publik nga nen. 297 par.5 lidhur me par.3 par dhe 1 të KPK-së.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe lartësisë së dënimit pati parasyshtë rrethanat të cilat në kuptim të nen. 64 të KPK-së ndikojnë në përcaktimin të llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata në kuptim të nen. 66 par.1. nën par.2. muarr se rrethanat veqanarisht lehtësuese tek i akuzuari pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte gjatë procedurës, pasi që vlerësoi rrezikshminë e kësaj vepre penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit përcaktoi që dënimi me burgim i shqiptuar ti zëvendsohet me dënimin me gjobë në kuptim të nen. 38 par.3. të KPPK-së duke qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi ndëshkimor i parapar në nen. 34 të KPPK-së.

Gjykata pasi që vlerësoi rrezikshmërinë e kësaj veprë penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe i caktoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muajve të cilin dënim në kuptim të nenit 38 par.3. të KPK-së pasi i akuzuari ka dhënë pëlqimin për zëvendësim, i njëjti i është vëvendësuar nga dënimi me burg në kohëzgjatje prej 3 muajve në dënim me gjobë dhe atë në shumën prej 1.350 € e të cilën gjobë gjykata ia ka mundësuar të dënuarit që ta paguaj me këste dhe atë në afat prej një viti nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit duke qenë e bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi ndëshkimi i parapar në nen.34 të KPK-së.

Në bazë të nen.463 par.2 të KPPK-së gjykata të dëmtuarin F.V.,nga fshati,Komuna Fereizaj, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike u udhëzuan në kontest civil.

Në bazë të nen. 450 par.2 nënpar 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së gjykata të akuzuarin e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 70 € si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 €.

Nga e gjithë sa u thekësua u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
P.nr .127/2013 dt. 08.08.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.